



Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL (MAPAS)

AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL (MAPAS)

Plani strategjik 2018-2020

“Për ditë më të sigurta pensionale”

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
PARATHËNIA E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË EKSPERTËVE	3
SISTEMI PENSIONAL NË MAQEDONI	7
AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL (MAPAS).....	9
PJESËMARRËSIT KRYESORË	13
QËLLIMET STRATEGJIKE TË MAPAS	14
Qëllimi kryesor 1:	17
Qëllimi 1.1	18
Qëllimi 1.2.....	21
Qëllimi 1.3.....	23
Qëllimi 1.4.....	25
Qëllimi 1.5.....	27
Qëllimi kryesor 2:	28
Qëllimi 2.1	29
Qëllimi 2.2.....	31
Qëllimi 2.3.....	33
Qëllimi 2.4.....	35
Qëllimi 2.5.....	36
Qëllimi kryesor 3:	37
Qëllimi 3.1	38
Qëllimi 3.2.....	40
Qëllimi 3.3.....	41
Qëllimi 3.4.....	43
Qëllimi 3.5.....	45
Plani financiar për realizim të planit strategjik	47
Konkluzion	49

PARATHËNIA E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË EKSPERTËVE

Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional – MAPAS është institucion rregullator dhe mbikëqyrës që në vazhdimësi kujdeset për interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe e nxit zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional. Parakushti kryesor për punë të suksesshme është identifikimi i gjendjeve qëllimore dhe prandaj MAPAS zbaton planifikim strategjik si pjesë e menaxhimit bashkëkohor dhe si mjetë për përshtatjen e shpejtë dhe efikase ndaj kushteve të ndryshueshme të veprimit. Në përgatitjen e planit strategjik trevjeçar të MAPAS-it kontribuuan të gjithë nëpunësit e MAPAS-it, në aspekt të projektimit të gjendjes në të ardhmen përmes propozimeve dhe ideve konkrete për analizë sistematike të ambientit të jashtëm dhe të brendshëm ku vepron MAPAS-i përmes vlerësimit të realizimeve të deritanishme të MAPAS-it dhe përmes përkufizimit të hapave që do të na udhëheqin.

Përmes analizës së gjendjes ekzistuese në të cilën punojmë dhe veprojmë, e përcaktuam misionin, vizionin dhe vlerat tona. Gjithashtu i identifikuam qëllimet tona kryesor të cilat duam dhe realisht mund t'i arrijmë në periudhë afatmesme, në pajtim me kapacitetet dhe resurset tona, përmes aktiviteteve të përcaktuara. Në kornizën e përcaktuar kohore i kemi përcaktuar edhe masat të cilat do të jenë tregues të qartë për suksesin e aktiviteteve. Gjendja e projektuar për të ardhmen të cilën e synojmë do të jetë motivi ynë kryesor drejt realizimit të qëllimeve.

Anëtarët e Këshillit të ekspertëve dhe të gjithë nëpunësit në MAPAS e përkrahin realizimin e planit strategjik dhe e ndjekin vazhdimisht përparimin e realizuar në drejtim të qëllimeve të vendosura.

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve

Dr. Bulent Dervishi

Misioni ynë është

që t'i mbrojmë interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe të nxisim zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional për ditë më të sigurta pensionale

Vizioni ynë është

*të njihemi si institucion i pavarur, profesional dhe transparent
i cili e mbrohet dhe avancohet sistemin pensional*

Vlerat tona janë

- **Profesionalizmi** - zbatimi i standardeve të pritshme nga një institucion profesional, në formë të besueshmërisë, diskrecionit, paanshmërisë dhe raportit të ndershëm në të gjitha sferat e veprimit e të tij.
- **Përgjegjësia** - marrja e përgjegjësisë për veprimet dhe për rezultatet e tyre
- **Puna ekipore** - punë e përbashkët për realizimin e qëllimeve tona dhe ndarjen e ideve dhe përvojave
- **Integriteti** - sigurimi i konsistencës, saktësisë dhe ndershmërisë gjatë realizimit të qëllimeve
- **Transparenca** - sigurimi i informimit në kohë dhe të qartë të opinionit për aktivitetet e MAPAS
- **Përkushtimi** - realizimi i përkushtuar i misionit dhe vizionit të MAPAS

SISTEMI PENSIONAL NË MAQEDONI

Sistemi pensional i Maqedonisë është pjesë e sigurimit social në Republikën e Maqedonisë. Ai ka strukturë të sistemit me tri shtylla me një mënyrë të kombinuar të financimit të pensioneve të ardhshme dhe diversifikimit të rreziqeve demografike dhe ekonomike, me qëllim të sigurimit të pensionit të sigurt për gjeneratat e ardhshme dhe të tanishme të pensionerëve dhe një stabilitet afatgjatë financiar të sistemit. Struktura e këtillë është rezultat i një reforme thelbësore të sigurimit pensional dhe invalidor që u përgatit ndër vite, ndërsa korniza e saj ligjore është krijuar në vitin 2000. Tri shtyllat e sistemit pensional të Maqedonisë janë:

- Shtylla e parë – sigurimi në bazë të solidaritetit të gjeneratave
- Shtylla e dytë – sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital
- Shtylla e tretë – sigurimi vullnetar pensional me financim kapital

Shtylla e parë financohet në bazë rrjedhëse (PAYG), që nënkupton se me kontributet e të siguruarve ekzistues paguhet edhe pensionet e pensionistëve aktualë. Kjo shtyllë funksionon në bazë të parimit të a.sh. pensione të definuar, respektivisht përmes tij sigurohen pensionet sipas një formule të parapërcaktuar për përlogaritjen e pensionit. Nga shtylla e parë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, pensionit invalidor, pensionit familjar, si dhe shuma më e ulët e pensionit.

Shtylla e dytë dhe e tretë janë sigurimi pensional me financim kapital në të cilën bëhet kapitalizimi i kontributeve të paguara në emër dhe për llogari të anëtarit. Ato dy shtylla funksionojnë në parimin e a.sh. kontribute të definuara, respektivisht te ato përcaktohet paraprakisht niveli i kontributit që paguhet, ndërsa pensioni përcaktohet më pas, varësisht nga shuma e akumuluar. Nga shtylla e dytë paguhet një pjesë e pensionit të moshës. Nga shtylla e tretë sigurohet mbrojtje nga mosha, invaliditeti dhe vdekja.

Sigurimi pensional me financim kapital në mënyrë radikale dallohet nga sigurimi i financuar vijues pensional dhe në aspekt të trajtimit dhe evidencës së kontributeve të paguara dhe aspekt të përcaktimit dhe pagesës së pensionit. Në këtë sigurim secili anëtar ka llogari individuale ku evidentohen mjetet e tij dhe sigurohet lidhshmëri dhe varësi e ngushtë ndërmjet vëllimit të kontributeve të paguara dhe pensioneve të ardhshme që do t'i realizojë çdo person. Kjo mënyrë e sigurimit është e bazuar në parimin e akumulimit të mjeteve nga kontributet e llogarive individuale, që më tutje investohen dhe të ardhurat e realizuara nga investimet, të zvogëluara për shpenzimet e punës së sistemit, në tërësi shtohen në mjetet e akumuluar në llogaritë individuale. Pensioni i ardhshëm varet nga mjetet e akumuluar në llogarinë individuale dhe nga kohëzgjatja e pritshme e jetesës gjatë pensionimit, respektivisht periudhës së pritur të shfrytëzimit të pensionit.

Institucionet që marrin pjesë në sistemin pensional janë:

- **Ministria e Punës dhe Politikës Sociale** – kompetente për krijimin dhe udhëheqjen e politikës së sigurimit pensional dhe invalidor dhe mbikëqyrje të realizimit të ligjshmërisë së atij sigurimi.
- **Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS)** - është institucion rregullator dhe mbikëqyrës, që i mbron interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale, e rrit vetëdijen e publikut për karakteristikat e atij lloji të sigurimit dhe e nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital.
- **Shoqëria pensionale** - shoqëri aksionare veprimtaria e vetme e së cilës është menaxhimi me mjetet e fondeve pensionale. Sistemi pensional në Maqedoni ka mundësi për themelimin e tri llojeve të shoqërive:
 - Shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale
 - Shoqëri për menaxhim me fondet vullnetare pensionale
 - Shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë dy shoqëri pensionale dhe secila prej tyre menaxhon me nga një fond të detyrueshëm dhe një vullnetar pensional. Të dy shoqëritë pensionale janë të themeluara nga aksionarë vendas (49% pjesëmarrje) dhe të huaj (51% pjesëmarrje).

- **Ruajtësit e pronës së fondit pensional** - bankë e cila i ruan në mënyrë të sigurt mjetet e fondit pensional në llogari të posaçme, veçmas prej mjeteve të shoqërisë pensionale. Funkcioni i ruajtësit të pronës, edhe për fondet e detyrueshme por edhe ato vullnetare pensionale, është nën kompetencë të bankave afariste që kanë lidhur marrëveshje me shoqëritë pensionale, për ruajtjen e mjeteve të fondeve pensionale.
- **Drejtoria e të Ardhurave Publike (DAP)** - realizon arkëtimin e centralizuar të kontributeve dhe dorëzon deri te FSPIM kontributet e përgjithshme për sigurim pensional dhe invalidor.
- **Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë (FSPIM)** - bën shpërndarjen e kontributeve për sigurim pensional ndërmjet shtyllës së parë dhe të dytë dhe bën transferimin e kontributeve dhe të dhënave adekuate për anëtarët sipas fondeve të detyrueshme që i kanë përzgjedhur.

AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL (MAPAS)

MAPAS është themeluar në korrik të vitit 2002 si organ mbikëqyrës dhe rregullator i financimit kapital të sigurimit pensional. MAPAS bën mbikëqyrje ndaj punës së shoqërive pensionale, fondeve pensionale dhe ruajtësve të pronës dhe miraton akte nënligjore dhe akte të tjera, me çka kontribuon për realizimin e plotë të ligjeve që e rregullojnë sigurimin pensional me financimin kapital.

Qëllimi themelor i MAPAS është që t'i mbrojë interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar dhe të nxisë zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë.

MAPAS është përgjegjës për dhënien, tërheqjen dhe shfuqizimin e lejeve për themelimin e shoqërive pensionale dhe të lejeve për menaxhim me fondet pensionale; bën mbikëqyrje të punës së shoqërive pensionale, fondeve pensionale si dhe të ruajtësve të pronës dhe të menaxhuesve të huaj të mjeteve. MAPAS bashkëpunon me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Financave, Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, Komisionin për Letra me Vlerë, Agjencinë për Mbikëqyrje të Sigurimit dhe me institucione të tjera me qëllim të kontrollit dhe rregullimit të suksesshëm të sigurimit pensional me financim kapital në Maqedoni. Krahas raportit vjetor të punës, MAPAS përgatit edhe publikon raport vjetor për gjendjen e sigurimit pensional me financim kapital, si një prej mënyrave për sigurimin e transparencës së sistemit.

Për momentin, MAPAS i realizon funksionet e tij me gjithsej 28 të punësuar. Me MAPAS-in udhëheq dhe menaxhon Këshilli i Ekspertëve, i përbërë prej pesë anëtarëve (tre ekspertë të angazhuar profesionalisht dhe dy anëtarë të jashtëm), prej të cilëve njëri është kryetar. MAPAS-i si institucion është e ndarë në pesë sektorë dhe dy seksione.

- **Seksioni për marrëdhënie me publik dhe standardizim:** Seksioni kujdeset për: proceset e nevojshme për organizimin e sistemit të menaxhimit me kualitet, në mënyrë që të vendoset, realizohen dhe mirëmbahet sistemi për mbrojtjen e të dhënave personale në MAPAS, procedurën e sigurimit të qasjes së lirë në informatat me karakter publik, krijimin e mënyrës dhe procedurës për informimin e publikut, përpilimin e njoftimeve për medime, organizimin e konferencave për shtyp, planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve për të ruajtur imazhin e mirë të MAPAS para publikut. Gjithashtu ky seksion është përgjegjës për organizimin dhe planifikimin e punëve dhe detyrave të kryetarit të Këshillit të Ekspertëve, anëtarëve të angazhuar profesional si dhe të


anëtarëve të jashtëm. Për momentin, në këtë sektor punon një udhëheqës sektori dhe dy udhëheqës të seksioneve.

- **Sektori për Informatikë:** Sektori për informatikë në MAPAS kujdeset për mirëmbajtjen e vazhdueshme të zgjidhjeve ekzistuese lidhur me shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, si dhe për zhvillimin e zgjidhjeve të reja softuerike në bashkëpunim me shtëpi të jashtme softuerike, për konsistencë të të dhënave në bazat e tyre, si dhe për vijimin e transferimit të të dhënave ndërmjet MAPAS-it dhe subjekteve me të cilat bashkëpunon. Sektori për Informatikë kujdeset edhe për mirëmbajtjen e serverëve si dhe pajisjeve të tjera harduerike me të cilat disponon MAPAS-i. Për momentin në këtë Sektor punojnë një udhëheqës sektori dhe një udhëheqës i seksioni.
- **Sektori për Kontroll Financiar:** Ky sektor bën kontroll financiar të fondeve pensionale dhe ruajtësve të pronës, në aspekt të kontrollit të pagesave të kontributeve në fondet pensionale, kontroll të investimeve dhe vlerësim të mjeteve të fondeve pensionale, si dhe kontroll të procesit të pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale në fondet pensionale. Për momentin në Sektorin për kontroll financiar punojnë një udhëheqës i sektorit, dy udhëheqës të seksionit dhe dy këshilltarë.
- **Sektori për Kontroll Institucional:** Ky sektor bën kontroll të punës administrative, organizative dhe financiare të shoqërive pensionale. Udhëheq me Regjistrin e anëtarëve dhe vepron ndaj lëndëve që dalin nga anëtarësimet në fondet pensionale, respektivisht kontrollon procedurën e anëtarësimit, transferimit dhe realizimit të të drejtave të anëtarëve. Për momentin, në Sektorin për kontroll institucional punon një udhëheqës i sektorit, dy udhëheqës të seksioneve, një këshilltar dhe një referent i lartë.
- **Sektori për Çështje Juridike:** Në kuadër të kompetencave të këtij sektori përgatiten aktet dhe dokumentet në lidhje me punën e MAPAS-it, realizohen procedurat e dhënies së lejeve dhe miratimeve për themelimin e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale, jepen leje për ndryshimet në shoqëritë pensionale dhe kryhen punët e resurseve njerëzore. Për momentin në këtë sektor punojnë një udhëheqës i sektorit, dy udhëheqës të seksioneve dhe një këshilltar.
- **Sektori për Hulumtim dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional:** Ky sektor ndjek dhe analizon sistemin pensional dhe bën hulumtime makroekonomike, përfshirë edhe përpilimin e raporteve statistikore dhe raporteve për gjendjen e sigurimit pensional me financim kapital, përpilon dhe përditëson programin për provimin për agjentë, propozimin e metodës për përllogaritjen e të ardhurave dhe ponderit dhe përllogaritjen e tyre, propozimin e metodologjisë për përllogaritje të pensioneve

dhe analiza të tjera për alternativa të reja të zhvillimit të sigurimit pensional me financim kapital. Gjithashtu ky sektor është përgjegjës edhe për ruajtjen e bashkëpunimit me institucionet me të cilat MAPAS ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi. Momentalisht, në këtë sektor punojnë një udhëheqës i sektorit dhe dy udhëheqës të seksioneve.

- **Sektori për Çështje Financiare Administrative:** Ky sektor është përgjegjës për çështjet administrative dhe financiare që janë të domosdoshme për funksionimin pa pengesa të MAPAS, që përfshijnë përpunimin dhe realizimin e planit financiar të MAPAS, raportet e punës financiare, kontabilitetit, realizimit të procedurave për ndarjen e marrëveshjeve për prokurime publike, punës arkivore dhe çështje të tjera administrative. Për momentin në këtë sektor punojnë një udhëheqës i sektorit, dy udhëheqës të seksionit dhe dy referentë të lartë.
- **Revizioni i brendshëm:** Detyrat themelore të revizionit të brendshëm janë vlerësimi i faktorëve të rëndësishëm të rrezikut dhe dhënia e këshillave për Këshillin e ekspertëve të MAPAS për uljen e faktorëve të rrezikut; përcaktimi dhe vlerësimi i ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të punës së sistemeve për menaxhim dhe kontrolli financiar dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e punës në bazë të analizave; kontrolli i saktësisë dhe kompletimit të evidencës së kontabilitetit dhe raporteve financiare; përcaktimi dhe vlerësimi i harmonizimit të punës sipas ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve interne dhe ndjekjen e realizimit të masave të ndërmarra nga anëtarët e Këshillit të ekspertëve në MAPAS, në bazë të raportit të revizionit. Për momentin në revizion të brendshëm punon një revizor i brendshëm i trajnimit.

ORGANIKA



PJESËMARRËS KRYESORË
KLIENTË TANË
Anëtarët e fondeve pensionale
Shoqëritë pensionale
Ruajtësit e pronës së fondeve pensionale
KLIENTË TANË TË ARDHSHËM
Qytetarët e Republikës së Maqedonisë
PJESËMARRËS TANË TË BRENDSHËM
Të punësuarit në MAPAS
Këshilli i Ekspertëve në MAPAS
PJESËMARRËS TANË TË JASHTËM
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Ministria e Financave
Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Kuvendi i Republikës së Maqedonisë
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë
Bursa e Maqedonisë
Komisioni për Letra me Vlerë
Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimit
Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë
Furnitorët
Konsulentët
BASHKËPUNËTORË TANË NDËRKOMBËTARË
Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve Pensionalë - IOPS
Delegacioni i BE-së
Mbikëqyrësit pensionalë nga vendet e tjera
PJESËMARRËS TJERË
Mediat
Odat ekonomike dhe sindikatat

QËLLIMET STRATEGJIKE TË MAPAS

Qëllimi kryesor 1: MAPAS do të sigurojë menaxhim me rreziqet që u kërcënohen mjeteve dhe pensioneve dhe kompensimeve pensionale të anëtarëve, si dhe reputacionit të sistemit, duke i çuar ato në nivelin më të ulët të mundshëm. Në këto suaza, nënqëllime më të rëndësishme të MAPAS do të jenë si vijon:

Qëllimi 1.1 - MAPAS do të krijojë kushte për arritjen e niveleve maksimale të të ardhurave në periudhë afatgjate me rrezik minimal, përmes promovimit të proceseve me kualitet të lartë për menaxhim me portofolet investuese.

Qëllimi 1.2 - MAPAS do të promovojë portfolio të ndryshme investuese në bazë të moshës së anëtarëve dhe fondeve pensionale dhe të gjitha mundësitë që do t'i kenë anëtarët, që nga ana tjetër, do ta lehtësojë edhe futjen e multifondeve.

Qëllimi 1.3 - MAPAS do të promovojë menaxhim korporativ me kualitet të lartë dhe menaxhim me rreziqet e shoqërive pensionale, për të siguruar minimizimin e rreziqeve.

Qëllimi 1.4 - MAPAS do të punojë në uljen e vazhdueshme të ndikimit që e kanë kompensimet që i arkëtojnë shoqëritë pensionale ndaj pensioneve të anëtarëve të fondeve pensionale, duke siguruar që kompensimet të jenë reflektim i një sistemi efikas të sigurimit pensional me financim kapital.

Qëllimi 1.5 - MAPAS do ta përmirësojë kornizën e realizimit të mbikëqyrjes së shoqërive pensionale, fondeve pensionale dhe ruajtësve të pronës në bazë të vlerësimit të rreziqeve të sistemit.

Qëllimi kryesor 2: MAPAS do të kontribuojë për zhvillimin e një sistemi të sigurt dhe transparent pensional që do ta ketë përkrahjen e anëtarësisë dhe publikut. Në këto suaza, si nënqëllime më të rëndësishme të MAPAS do të jenë:

Qëllimi 2.1 - MAPAS në vazhdimësi, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për qytetarët, do t'i sqarojë karakteristikat, mundësitë dhe përparësitë e sigurimit pensional me financim kapital.

Qëllimi 2.2 - MAPAS do ta avancojë kualitetin e informacioneve që u dorëzohen anëtarëve të fondeve pensionale në lidhje me të drejtat, obligimet dhe interesat e tyre, me qëllim të ndërtimit të besimit të sistemit dhe në mënyrë transparente dhe efikase të përmbushen kërkesat e anëtarëve.

Qëllimi 2.3 - MAPAS do të përpiqet të sigurojë përditësim të rregullt të të dhënave të anëtarëve në Regjistrin e anëtarëve dhe në evidencat e të dhënave të institucioneve të tjera që i përpunojnë të dhënat.

Qëllimi 2.4 - MAPAS do të garantojë besueshmëri dhe konsistencë të bazës së të dhënave.

Qëllimi 2.5 - MAPAS në mënyrë aktive do të përfshihet në realizimin e fazës së pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale.

Qëllimi kryesor 3: MAPAS do ta përmirësojë kapacitetin në drejtim të forcimit të rolit të tij mbikëqyrës dhe rregullator të sistemit pensional. Në këtë kuadër, si nënqëllime të MAPAS do të jenë:

Qëllimi 3.1 - MAPAS vazhdimisht do të përsosë profesionalizmin e organeve udhëheqëse dhe të punësuarve.

Qëllimi 3.2 - MAPAS vazhdimisht do të sigurojë procese më efikase zyrtare për rregullim, mbikëqyrje dhe kontroll.

Qëllimi 3.3 - MAPAS do të menaxhojë me të dhënat në mënyrë profesionale, moderne dhe efikase dhe do të sigurojë mbrojtjen e tyre, do t'i përsosë dhe thjeshtësojë proceset për menaxhimin e të dhënave.

Qëllimi 3.4 – MAPAS vazhdimisht do të bashkëpunojë me trupat tjerë mbikëqyrës të vendit dhe të huaj, do të jetë pjesë e shoqatave ndërkombëtare dhe do të zbatojë proceset dhe rekomandimet më të reja nga sfera e mbikëqyrjes

Qëllimi 3.5 – MAPAS do të përpiqet për forcimin dhe ruajtjen e stabilitetit të vet financiar me qëllim të zbutjes së ndikimeve në të gjitha segmentet e fushëveprimit duke siguruar menaxhim efikas me financat

Qëllimi kryesor 1:

MAPAS do të sigurojë menaxhim me rreziqet që u kërcënohen mjeteve dhe pensioneve si dhe kompensimeve pensionale të anëtarëve, si dhe reputacionit të sistemit, duke i ulur ato në pikën më të vogël të mundshme.

Kursimi pensional është investim afatgjatë që duhet të menaxhohet, duke ruajtur baraspeshën ndërmjet rrezikut dhe të ardhurave që optimizohet gjatë ciklit jetësor të anëtarëve. Sistemi ekzistues u imponon stimulime të fuqishme shoqërive pensionale për të arritur minimizimin afatshkurtër të paqëndrueshmërisë që mund të arrihet vetëm nëse rriten rreziqet e tjera, si dhe p.sh. mospërshtatja e afateve (duration mismatch) dhe inflacioni, shikuar në afat më të gjatë, dhe me këtë kufizohen edhe mundësitë për realizimin e të ardhurave më të mëdha (të ardhurat që mund të vendosen si qëllim ose që janë realizuar). MAPAS do të punojë edhe në drejtim të uljes së llojit të këtyllë të stimulimeve, me çka do të zhvillojë qasje më intensive strategjike ndaj investimit, me ç'rast si qëllim do t'i vendos të ardhurat afatgjate dhe menaxhimin me rreziqet përkatëse. Gjithashtu, MAPAS do të përpiqet për transparencë më të madhe në drejtim të transformimit të asaj strategjie në hapa konkrete, si dhe për pjekuri më të madhe të procesit të menaxhimit me rreziqet. Gjithashtu, MAPAS do të insistojë në implementimin e drejtë të procedurave të ardhshme ligjore që kanë të bëjnë me multifondet dhe që kanë rëndësi të jashtëzakonshme për optimizimin e portofoleve. Kompensimet që paguhen nga ana e shoqërive pensionale, dukshëm do ta ulin vlerën e skajshme të pensioneve dhe kompensimeve pensionale, nëse ato paguhen gjatë periudhës së punës së anëtarëve, kështu që nevojitet që MAPAS edhe më tutje të vazhdojë me qasjen e tij të suksesshme për uljen e vazhdueshme të kufirit të epërm të kompensimeve për shkak të uljes së ndikimit të tyre.

Qëllimi 1.1

MAPAS do të krijojë kushte për arritjen e shkallëve maksimale të të ardhurave në afat të gjatë me rrezik minimal përmes promovimit të proceseve me cilësi të lartë për menaxhim me portofolet investuese

Në fillesat e sistemit, përderisa shoqëritë pensionale i zhvillonin kapacitet dhe profesionalizmin, kuptohet që minimizimi i paqëndrueshmërisë investuese do të jetë shtytës i dukshëm i sjelljes investuese. Në atë periudhë të ardhurat reale ishin goxha të ulëta dhe të planifikuara në afat të shkurtër. Por, të të cilën MAPAS e pret nga shoqëritë pensionale është se ato të arrijnë pjekuri në funksionin investues, me atë që aktivisht do të punojnë në arritjen e të ardhurave më të larta të dëshiruara nga investimet në afat të gjatë, dhe në pajtim me parimin e prurës, do të ruhet balanca ndërmjet rrezikut dhe të ardhurave. Kjo do të thotë se anëtarët e këshillave administrative të shoqërive pensionale duhet ta bindin MAPAS se:

- Vendimet që kanë të bëjnë me portofolin e fondit pensional bazohen në analizë të cilësisë së lartë dhe këshillimore dhe këshillave;
- Qëllimi i fondeve pensionale është të ardhura më të larta të mundshme në afat të gjatë, ndërsa realizueshmëria e tij të bazohet në analizat paraprake;
- Në strategjinë investuese janë përshkruar veprime të cilat do të ndërmerren në afat të gjatë, me qëllim të realizimit të të ardhurave më të larta vetëm në favor të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit pensional dhe përmes diversifikimit dhe analizës financiare të minimizohet rreziku nga humbjet që kanë ndodhur për shkak të mospagesës së emetuesit ose palës tjetër kontraktuese të cilët dalin nga ndikimi i tregjeve vendore dhe të huaja financiare dhe që janë pasojë e shitjes së mjeteve të fondit pensional për shkak të sigurimit të likuiditetit të fondit pensional;
- Në bazë të kësaj strategjie së paku njëherë në vit për çdo fond pensional përgatitet dokument për mënyrën e zbatimit të strategjisë investuese për 12 muajt e ardhshëm, që përmban qëllime precize dhe shmangie të lejuara për investim sipas klasave të mjeteve, kufizime të brendshme, paqëndrueshmëri relative sipas klasave të mjeteve dhe ekspozim ndaj rreziqeve;
- Të gjitha aktivitetet investuese janë në pajtim me dokumentacionin investues dhe çdo mospërputhje me dokumentacionin investues mënjanohet shpejt;
- Personat e autorizuar për menaxhim me rreziqet i ndjekin vazhdimisht rreziqet dhe njoftojnë për rreziqet që i kërcënohen portofolit dhe ndërmarrin masa përkatëse për minimizimin e tyre.
- Anëtarët e Këshillit drejtues rregullisht i përcjellin rezultatet e investimit në bazë të analizave të detajuara, të përgatitura nga sektorët.
- Në këtë drejtim, funksioni i MAPAS do të jetë që të punojë vazhdimisht me shoqëritë pensionale me

qëllim që të sigurohen se ato zbatojnë politika adekuate dhe veprojnë drejtë me të dhe njëkohësisht e zvogëlon insistimin e tyre për planifikim në afat më të shkurtë.

- MAPAS do t'i analizojë informatat që dalin nga raportet për portfoliot e fondeve pensionale dhe do të kontrollojë edhe në terren të gjitha proceset dhe politikat, në drejtim të konfirmimit se përparimi është i kënaqshëm dhe se shoqëritë pensionale punojnë sipas përvojave më të mira në sferën e investimit dhe se procedurat e tyre nuk dalin jashtë planeve të tyre investuese. Për të forcuar praktikën e mirë në këtë sferë, MAPAS do të kërkojë vërtetim nga shoqëritë pensionale se ndërmarrin veprime për zhvillimin e analizave, strategjive të tyre dhe menaxhimit me rreziqet dhe vërtetim për realizimin e tyre. Njëherë, MAPAS do t'u ndihmojë shoqërive pensionale për të pasur mirëkuptim për përvojat më të mira gjatë realizimit të obligimeve të asaj sferë. Ajo mund të realizohet edhe përmes seminareve, udhëzimeve dhe gjithësesi edhe përmes rregulloreve.
- MAPAS pret që shoqëritë pensionale në mënyrë të pavarur ta njohin nevojën për zhvillimin e proceseve zyrtare të punës, veçanërisht në drejtim të inkuadrimit të multifondeve, që vetvetiu kërkon një përsosmëri më të madhe. Gjithësesi, MAPAS, për t'i shmangur problemet e mundshme, do të propozojë ndryshime të rregullativës. Kjo është pjesë e Qëllimit 1.5 dhe nënkupton se vendimet investuese janë të harmonizuara me parimin e prurës, me planet vjetore investuese dhe me menaxhimin e rreziqeve.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Shkalla reale e të ardhurave	4,71%	Rritja	Të dhënat e MAPAS
Shoqëritë pensionale punojnë në pajtim me strategjitë investuese të fondeve të tre pensionale, si dhe me të ardhurat e dëshiruara	Pjesërisht	Tërësisht	MAPAS dhe strategjitë investuese të fondeve pensionale
Ndikimi i MAPAS mbi rreziqet investuese	50%	95%	Analiza e rreziqeve në sigurimin pensional me financim kapital

Aktivitetet kryesore

1. Vazhdimi i aktiviteteve për mbikëqyrjen e rreziqeve të investimit.
2. Përgatitja e raporteve analitike për rreziqet që i kërcënohen portofolit investues.
3. Analizimi i raporteve të ruajtësve të pronës për mjetet e fondeve pensionale

Oëllimi 1.2.

MAPAS do të promovojë portofole të ndryshme investuese në bazë të moshës së anëtarëve të fondeve pensionale dhe të gjitha mundësive të cilat do t'i kenë anëtarët, gjë që do ta lehtësojë futjen e multifondeve.

Për momentin çdo shoqëri pensionale menaxhon me nga një fond të detyrueshëm dhe një vullnetar pensional. Parimi i personit të matur potencon që fondet pensionale duhet të optimizohen në mënyrë adekuate për t'u aftësuar ndaj rrethanave specifike të secilit anëtar. Konkretisht, kohëzgjatja optimale e instrumenteve financiare varet nga koha e mbetur deri në pensionim, si dhe shkalla deri të cilën anëtarët mund të ekspozohen ndaj paqëndrueshmërisë së tregut pa pasur humbje që nuk mund të kompensohen para periudhës së pensionimit. Në fakt, mundësia se paqëndrueshmëria e tregut do të mund të shkaktojë pasoja serioze para pensionimit, paraqet një prej iniciativave për planifikim të investimit sipas periudhës së pensionimit të anëtarëve.

Si zgjidhje më e pranueshme dhe më e rekomanduar ndërkombëtare për këtë problem është investimi strategjik i mjeteve të anëtarëve sipas kohës së mbetur deri në pensionim (monitorimi i ciklit jetësor).

Në këtë aspekt, praktika dëshmon se vendimet për ndryshime në investimin e mjeteve janë të lidhura me moshën, që nuk do të thotë domosdoshmërisht të përshtaten me rrethanat specifike të anëtarit. Prandaj, zakonisht i jepet mundësi anëtarit që të zgjedh portofol, për t'i shmangur vendimet për investimin e mjeteve, që në të kundërtën, do t'i shtoheshin te mjetet e tjera.

Në vendet që kanë sistem të ngjashëm me sistemin pensional të Maqedonisë, “multifondet” shfrytëzohen si një metodë standarde për investim sipas ciklit jetësor me të cilin anëtarit i jepet mundësi për të zgjedhur. Për këtë arsye, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale propozon futjen e këtij modeli. Kështu, edhe në sigurimin pensional me investim kapital të detyrueshëm dhe në atë vullnetar, do të ketë nga tri fonde pensionale që do të dallohen edhe për nga mënyra e investimit të mjeteve dhe përkatësisht me të, do të mund të zgjedhin fond pensional. Anëtarët që nuk do të zgjedhin vetë fond, do të shpërndahen në mënyrë automatike në fond që i përshtatet moshës së tyre. Pas miratimit të rregullativës, do të vijojë një periudhë kalimtare për të harmonizuar investimin e mjeteve.

Siç është cekur më lartë, shoqëritë pensionale do të duhet që të forcojnë kapacitetet e veta për t'i implementuar multifondet. MAPAS do të bëjë kontroll ndaj shkallës së zhvillimit të kapaciteteve të shoqërive për të përcaktuar nëse janë në nivelin e kënaqshëm dhe nëse janë në pajtim me funksionin që e kryejnë. Njëkohësisht, MAPAS do ta kontrollojë edhe menaxhimin me rreziqet që i kërcënohen sistemit, e që dalin nga vet futja e multifondeve.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, MAPAS do të kujdeset për implementimin adekuat të asaj risie, përfshirë edhe përgatitjen e rregulloreve adekuate.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Futja e multifondeve	-	100	Të dhënat e MAPAS
Përgatitja e rregullave ligjore dhe rregulloreve	-		MAPAS dhe strategjitë investuese të fondeve pensionale
Programe për trajnim për multifondet	-		Analiza e rreziqeve në sigurimin pensional me financim kapital

Aktivitetet kryesore

1. Pjesëmarrja në përgatitjen e rregullativës ligjore në lidhje me inkuadrimin e multifondeve
2. Vlerësimi i gatishmërisë momentale
3. Përgatitja e rregullave nënligjore dhe ndryshimeve në procese dhe në softuerin e MAPAS me qëllim të futjes së multifondeve
4. Realizmi i programeve për trajnime për multifondet
5. Njoftimi i publikut me multifondet

Qëllimi 1.3

MAPAS do të promovojë menaxhim kualitativ korporativ dhe menaxhim me rreziqe të shoqërive pensionale për të siguruar minimizimin e rreziqeve.

Rreziqet e shoqërive pensionale do të zvogëlohen ose do të mbahen në nivel të ulët nëse ekzistojnë kontrole që do të zbatohen drejt ose nëse shoqëritë kanë inkuadruar politika adekuate për realizimin efektiv të obligimeve ndaj anëtarëve të fondeve pensionale. Ajo do të arrihet veçanërisht nëse shoqëritë pensionale kanë metoda të suksesshme për menaxhim me rreziqe. Një pjesë e obligimit fiducijar të këshillave drejtues të shoqërive pensionale është që të sigurojnë se të janë bërë të gjitha kontrollet e nevojshme dhe se vendimet janë miratuar në mënyrë objektive, në bazë të argumenteve të mjaftueshme dhe kuptimit të rrezikut, duke e përjashtuar mundësinë për t'u paraqitur konflikt i interesave.

MAPAS do ta forcojë këtë porosi duke i përkufizuar qartë obligimet e shoqërive pensionale dhe duke e kontrolluar realizimin e tyre. Prioriteti për përmirësim të menaxhimit korporativ të shoqërive pensionale është që të kenë mundësi të tregojnë se janë në tërësi të harmonizuar me kontrollin e brendshëm dhe rregullorët dhe se e kanë zhvilluar funksionin e menaxhimit me rreziqe. Prandaj, MAPAS do të kërkojë nga shoqëritë pensionale që të dorëzojnë vërtetim vjetor se kanë krijuar procedura adekuate për menaxhim korporativ. Pastaj, MAPAS do ta kontrollojë respektimin dhe harmonizimin e tyre me qëllim që të sigurohet se shoqëritë pensionale nuk e kanë informuar gabimisht MAPAS.

Pasi të sigurohet se sistemi i menaxhimit të shoqërive është adekuat, atëherë MAPAS do të jetë më efikas gjatë punës së vet sepse do të mund që një pjesë të përgjegjësive për proceset kryesore kontrolluese do t'ua bartë edhe shoqërive. Kjo mund të ndodh vetëm kur MAPAS do të ketë besim të mjaftueshëm në menaxhimin e shoqërive pensionale, që në fakt paraqet edhe një arsye më tepër që MAPAS t'i forcojë porosinë në këtë drejtim për shoqëritë.

Sigurimi i standardeve të larta të menaxhimit korporativ dhe menaxhimit me rreziqe nënkupton që MAPAS t'u thotë qartë shoqërive pensionale se në fakt pret prej tyre të marrë pëlqim në lidhje me këtë. Kjo mund të bëhet edhe përmes Kodit të menaxhimit korporativ që paraqet një pikënisje të mirë.

Pastaj, MAPAS do ta kontrollojë implementimin dhe do t'u propozojë shoqërive pensionale mënjanimin e parregullsive, e tërë këtë do ta bazojë me mundësinë për iniciimin e masave në shkallë më të lartë në shoqëritë nuk përshtaten me kërkesat e MAPAS.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Zbutja e rreziqeve nga MAPAS të cilat bëjnë pjesë në 1.1	45%	70%	Raportet e MAPAS nga kontrolli i terrenit për mbikëqyrje të vlerësimit të rrezikut

Aktivitetet kryesore

1. Vazhdimi i aktiviteteve mbikëqyrëse që kanë të bëjnë me ato rreziqe
2. Vlerësimi i menaxhimit korporativ dhe kapaciteteve për kontroll të brendshëm të shoqërive pensionale
3. Bërja e hulumtimit për përmirësim të cilësisë së metodologjisë për menaxhim korporativ
4. Dhënie e rezultateve dhe realizimi i trajnimeve për menaxhim korporativ të shoqërive pensionale

Qëllimi 1.4

MAPAS do të punojë në uljen e vazhdueshme të ndikimit që e kanë kompensimet që paguhen në shoqëritë pensionale ndaj pensioneve të anëtarëve të fondeve pensionale, ku sigurimi i kompensimeve të jetë reflektim i një sistemi efikas i sigurimit pensional me financim kapital

Në pajtim me Ligjin për sigurim pensional me financim të detyrueshëm kapital dhe Ligjin për sigurim pensional me financim vullnetar kapital, shoqëritë pensionale arkëtojnë kompensime nga kontributet dhe mjetet si dhe kompensime për premi. Arkëtimi i kompensimeve është i domosdoshëm që të mund shoqëritë pensionale t'i kryejnë funksionet e tyre në lidhje me menaxhimin e fondeve pensionale. Për realizimin e funksioneve dhe aktiviteteve të veta, kompensime nga këto shoqëri pensionale arkëtojnë edhe ruajtësit e pronës dhe MAPAS, por krahasuar me vitet e para të punës së sistemit, të njëjtat janë shumë më të ulëta dhe e kanë ulur dukshëm vetë rritjen e sistemit.

Kompensimet e larta mund të ndikojnë dukshëm në vlerën e pensioneve të ardhshme dhe pikërisht për këtë arsye duhet të mbahen në nivel minimal, e që prapë se prapë do t'u mundësojë shoqërive pensionale që të realizojnë të ardhura adekuate në raport me shpenzimet e realizuara. Në Republikën e Maqedonisë nuk ekziston konkurrencë e mjaftueshme ndërmjet shoqërive pensionale për të arritur ato efekte, por edhe përvoja ndërkombëtare dëshmon se konkurrenca si faktor, nuk ka arritur ndonjë sukses për uljen e kompensimeve. Në vend të kësaj, me ligj janë përcaktuar shumatat maksimale të kompensimeve.

Procesi i përcaktimit të shumës maksimale të kompensimeve duhet të jetë mjaftë objektiv dhe i drejtë për të gjitha palët e theksuara dhe kështu të shmanget çfarëdo ndikimi politik. Së këndejmë del edhe roli kryesor i MAPAS si një institucion profesional për të shqyrtuar se cilat shpenzime janë të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të shoqërisë pensionale dhe për të dhënë këshilla në aspekt të uljeve të ardhshme të shumës maksimale të kompensimeve. Shumat maksimale të kompensimeve duhet të përcaktohen me nivele dhe paraprakisht të iniciohen kontrole të rrepta të shpenzimeve të shoqërive pensionale. Kjo u siguroi në vitin 2013 përmes ndryshimeve të Ligjit për sigurim pensional me financim të detyrueshëm kapital, kur edhe u përcaktuar shuma maksimale e kompensimit nga kontributet dhe kompensimi i mjeteve që mund t'i arkëtojnë shoqëritë pensionale. MAPAS edhe më tutje do të vazhdojë me kontrollin për shpenzimet e realizuara për të cilat paguhet drejtpërdrejt nga anëtarët ose nëse të ardhurat e shoqërive pensionale janë ligjore dhe të arsyeshme.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Analiza vjetore e shpenzimeve të sistemit të sigurimit pensional me financim kapital			Të dhënat e MAPAS
Kompensimi nga kontributet* (maksimal)	3,00%	2,00%	Ligji për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital
Kompensimi për menaxhim me mjetet – mujor* (maksimal)	0,040%	0,030%	Ligji për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital

*Nga viti 2013 me ligj është caktuar shuma maksimale e kompensimit nga kontributet dhe kompensimi nga mjetet që do të mund ta arkëtojnë shoqëritë pensionale dhe është paraparë zvogëlimi i tyre gradual i mëtejme.

Aktivitetet kryesore

1. Përcjellja dhe shqyrtimi i shpenzimeve të sistemit dhe kompensimet e brokerëve
2. Analiza e kompensimeve që arkëtohen nga shoqëritë pensionale
3. Shqyrtimi i mundësive për ndryshime të mëtutjeshme të shumës maksimale të kompensimeve të përcaktuara me ligj.

Qëllimi 1.5

MAPAS do ta përmirësojë kornizën për mbikëqyrje të shoqërive pensionale, fondeve pensionale dhe ruajtësve të pronës në bazë të vlerësimit të bërë të rreziqeve të sistemit.

Për t'u siguruar menaxhimi me rreziqet dhe minimizimi i tyre, MAPAS i nevojiten procese me ndihmën e të cilëve do të identifikohen dhe vlerësohen rreziqet në mënyrë strukturore prej ku do të merren informata për atë se çfarë prioritete dhe çfarë testimesh duhet të zbatohen për secilin rrezik dhe çfarë masa shtesë duhet të ndërmerren. Kështu, resurset mund të orientohen drejt këtyre rreziqeve për të cilat ekziston një probabilitet i madh se do të ndikojnë në pensionet e ardhshme të anëtarëve dhe të qëndrueshmërisë së sistemit. Gjithashtu, resurset do të orientohen edhe aty ku rreziku ka përfshirje më të madhe dhe duhet të zbutet, në këtë drejtim duke i ndihmuar edhe MAPAS për të përgatitur dhe propozuar ndryshime me të cilat mund të ulet nivel i rrezikut.

Komiteti për vlerësimin e rreziqeve e koordinon procesin e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve, njëherë në pjesën e kontrollit të terrenit dhe jashtë tij, i shqyrton duke propozuar përmirësimin e metodave për vlerësimin e rreziqeve.

Në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes është miratuar edhe një Rregullore për mbikëqyrje të bazuar në rreziqe dhe i njëjti do të rishqyrtohet sipas nevojës.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Rishikimi i Analizës së rreziqeve në sigurimin pensional me financim kapital	1	1	Raporte të MAPAS nga kontrolli në terren të bazuar në vlerësimin e rrezikut
Mbledhjet e Komitetit për Vlerësim të Rreziqeve	4	4	Procesverbalet nga mbledhja e Komitetit për Vlerësim të Rreziqeve

Aktivitetet kryesore

1. Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve dhe rishikimi i rreziqeve
2. Mbajtja e konsideratës që aktivitetet inspektuese të orientohen ndaj rreziqeve në pajtim me shkallën e tyre të seriozitetit
3. Kryerja e kontrollit në pajtim me Doracakun për mbikëqyrje të bazuar në rreziqe dhe rishikimi i tij sipas nevojës

Qëllimi kryesor 2

MAPAS do të kontribuojë për zhvillimin e një sistemi pensional të sigurt dhe transparent që e ka përkrahjen e anëtarësisë dhe publikut

Sistemi i sigurimit pensional me financim kapital paraqet element i rëndësishëm në kuadër të mekanizmave të cilat qytetarëve të Republikës së Maqedonisë mund t'u shërbejnë për sigurim të sigurisë financiare pas pensionimit të tyre. Pronarë të fondeve pensionale janë anëtarët dhe prandaj është shumë e rëndësishme ekzistimi i përgjegjësisë dhe transparencës gjatë menaxhimit me fondet pensionale. Anëtarët dhe anëtarët e pensionuar duhet të kenë qasje të shpejtë në informatat që kanë të bëjnë me llogaritë e tyre dhe punën e sistemit. Ai sistem dallohet dukshëm nga shtylla e parë që e kanë të njohur qytetarët dhe është shumë e rëndësishme që anëtarët dhe publiku të kenë ide të qartë se si funksionon ai sistem dhe cilat janë përfitimet nga ajo se si do të kuptohet nga anëtarësia dhe publiku, si dhe nga mbështetja e cila do t'i jepet. MAPAS luan rol kryesor në realizimin e këtij qëllimi.

Qëllimi 2.1

MAPAS në vazhdimësi, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për qytetarët, do t'i sqarojë karakteristikat, mundësitë dhe përparësitë e sigurimit pensional me financim kapital

Një fakt mirë i njohur është se te publiku dhe mediumet ende ekziston mungesë e njohurive për përfitimet që i ofron sigurimi pensional me financim dhe rolin që e ka MAPAS në sistemin pensional. Rritja e vetëdijes së publikut dhe rritja e përkrahjes ndaj sistemit pensional do ta forcojë zhvillimin e sistemit, njëkohësisht edhe do ta ulë edhe probabilitetin për paraqitjen e pengesave në periudhë afatgjate. Roli i MAPAS, që është e rregulluar me ligj dhe që nënkupton përgjegjësi për aktivitetet e veta, i mundëson MAPAS që të ketë rolin udhëheqës për rritjen e vetëdijes njerëzore. Raportet e MAPAS për funksionimin e sistemit japin një bazë të mirë për përhapjen e informatave përmes kanaleve të ndryshme, por ajo duhet të jetë vetëm një pjesë e një strategjie më të gjerë komunikuese.

MAPAS, në kuadër të kompetencave të veta për rritjen e vetëdijes së publikut për qëllimet dhe parimet e sigurimit pensional me financim kapital, dhe të drejtat e anëtarëve të fondeve pensionale, realizon edukimin e anëtarëve dhe të publikut, veçanërisht të rinjve, me qëllim të rritjes së vetëdijes dhe informimin e të siguruarve në lidhje me sistemin. Në drejtim të rritjes së vetëdijes pensionale të publikut, nga viti 2016 MAPAS ka filluar shënimin e “Ditës së vetëdijes pensionale – 15 shtator”. Për këtë qëllim më 15 shtator 2016 dhe 2017 u realizuan konferenca para përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, trupave rregullatorë, bashkëpunëtorëve dhe mysafirëve nga vendi dhe jashtë. MAPAS edhe më tutje do të vazhdojë me organizimin e aktiviteteve për shënimin e ditës së vetëdijes pensionale. Pastaj një pjesë e aktiviteteve për informimin e publikut do të realizohen edhe në bashkëpunim me shoqëritë ekzistuese pensionale. Gjithashtu, MAPAS është e orientuar në realizimin e aktiviteteve të marketingut për promovimin e rëndësisë dhe rolit të MAPAS.

Duke marrë parasysh faktin se pjesëmarrja në shtyllën e tretë, ende nuk e ka arritur pritshmërinë, MAPAS do t'u kushtojë vëmendje të veçantë aktiviteteve për promovim me qëllim të shtimit të pjesëmarrjes në shtyllën e tretë, e njëkohësisht duke i inkurajuar edhe shoqëritë pensionale për ta bërë të njëjtën. Pikërisht për këtë, MAPAS do të ndihmojë për rritjen e vetëdijes së publikut dhe për ta përmirësuar kuptimin e sistemit, si dhe promovimin e sigurimit vullnetar pensional me financim kapital.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Niveli i informimit personal dhe njoftimi me shtyllën e dytë	niveli i mesëm	rritja	Hulumtimi
% e anëtarëve që janë të informuar dhe të njoftuar mjaftueshëm me shtyllën e dytë	50**	70%	Hulumtimi
% e anëtarëve që kanë mendim pozitiv për punën e shoqërive dhe fondeve pensionale	62%***	80%	Hulumtimi
Numri i anëtarëve të rinj në shtyllën e III	1250	4000	Të dhënat e MAPAS
Numri i aktiviteteve për rritje të vetëdijes së publikut	16****	20	Të dhënat e MAPAS

*Sipas mendimit të pjesëmarrësve në anketën telefonike të anëtarëve të realizuar në vitin 2015 (mesatare e përllogaritur nga përgjigjet)

** Sipas mendimit të pjesëmarrësve në anketën telefonike të anëtarëve të realizuar në vitin 2015 (përgjigje të përfshira: ashtu – ashtu, mirë dhe shkëlqyeshëm)

*** Sipas mendimit të pjesëmarrësve në anketën telefonike të anëtarëve të realizuar në vitin 2015 (përgjigje të përfshira: mirë, shumë irë dhe shkëlqyeshëm)

****Është përfshirë aktivitetet për iniciimin e fushatës së marketingut të shoqërive pensionale “Çfarë pensionisti je bërë?”

Aktivitetet kryesore

1. Dhënia e informatave për pjesëmarrësit në sistemin pensional
2. Realizimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes së publikut për sistemin pensional
3. Hulumtimi i mendimeve të pjesëmarrësve

Qëllimi 2.2

MAPAS do ta avancojë kualitetin e informatave për anëtarët e fondeve pensionale në lidhje me të drejtat, obligimet dhe interesat e tyre, me qëllim të ndërtimit të besimit në sistemin dhe në mënyrë transparente dhe efikase t'i përmbushë kërkesat e anëtarëve.

Duke marrë parasysh se pjesa më e madhe e anëtarëve të fondeve pensionale nuk kanë njohuri adekuate për sigurimin pensional me financim kapital dhe sistemin pensional në përgjithësi, mund të thuhet se ajo i bënë edhe më të ekspozuar ndaj konkluzioneve të gabuara në lidhje me pensionet e tyre të ardhshme, që nga ana tjetër mund të sjellë deri te vendime të gabuara dhe dëshpërime. Gjithashtu, anëtarët nuk dinë se çfarë të presin nga shoqëritë e tyre pensionale, çfarë mbrojtje është e paraparë për pensionet e tyre, e as se kush është përgjegjës për sigurimi e saj. Pikërisht për këtë, roli i MAPAS dhe shoqërive pensionale është që t'u ndihmojnë anëtarëve ta kuptojnë sistemin në mënyrë të drejtë.

Mirëpo, është e qartë se nëse MAPAS dëshiron që ta rrit nivelin e vetëdijes dhe mirëkuptimin e anëtarëve, duhet të orientohet drejt hulumtimeve të mendimit të anëtarëve që më pas ta përmirësojë njohurinë e tyre për sistemin dhe të punojë në forcimin e kanaleve komunikuese. MAPAS gjithashtu duhet ta kontrollojë mënyrën se si shoqëritë pensionale komunikojnë me anëtarët, veçanërisht në fazën e dhënies së informatave kur anëtarët kyçen në një fond të caktuar pensional. Në përgjithësi, MAPAS do t'u japë informata atyre personave që janë më anëtarë dhe atë me kërkesë të tyre, përfshirë edhe informata për shpërndarjen e tyre në fondin e detyrueshëm pensional.

Edhe krahas aktiviteteve për marketing dhe shitje të shoqërive pensionale, mund të ndikojnë edhe në përmirësimin e mirëkuptimit të sigurimit pensional me financim kapital te anëtarët dhe anëtarët potencial, e këto aktivitete nëse nuk kontrollohen mirë, mund t'i hutojnë qytetarët e që si pasojë mund të sjellë uljen e besimit ndaj sistemit. Së këndejmë, MAPAS duhet të sigurojë kushte në të cilat shoqëritë pensionale do ta realizojnë me sukses kontrollin e aktiviteteve të tyre të marketingut dhe të sigurojë zgjidhjen e të gjitha problemeve që do të paraqiten.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
% e anëtarëve që janë mjaft të informuar dhe të njoftuar me rolin e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale	47%	70%	Hulumtimi
% e ankesave të zgjidhura në afat prej 15 ditësh	100%	100%	Të dhënat MAPAS
Niveli i informimit të anëtarëve për të drejtat dhe obligimet e tyre	Niveli mesatar**	Rritja	Hulumtimi
% e anëtarëve për të cilët informatat në zarf të gjelbër janë mjaft të dobishme dhe të qarta -	78*	100%	Hulumtimi
Trajnimi i agjentëve të shoqërive pensionale	1	1	Të dhënat e MAPAS

*Sipas mendimit të pjesëmarrësve në anketën telefonike të realizuar në vitin 2015 (përgjigje të përfshira ashtu – ashtu, mirë dhe shkëlqyeshëm)

**Sipas mendimit të pjesëmarrësve në anketën telefonike të realizuar në vitin 2015 (mesatare e përlogaritur nga përgjigjet)

Aktivitetet kryesore

1. Zhvillimi i një sistemi të ankesave nga anëtarët dhe zgjidhjen e problemeve të anëtarëve
2. Informimi i rregullt i anëtarëve për të drejtat dhe obligimet e tyre
3. Hulumtime në lidhje me atë nëse informatat që u dorëzohen anëtarëve janë të kuptueshme
4. Vazhdimi i organizimit të provimit për agjentë dhe regjistrimin e agjentëve të shoqërive pensionale
5. Veprimi ndaj çdo lloji të informimit të gabueshëm të anëtarëve nga ana e agjentëve të shoqërive pensionale

Qëllimi 2.3

MAPAS do të përpiqet për sigurimin e një azhurnimi të rregullt të të dhënave për anëtarët e Regjistrit të anëtarëve dhe evidencave me të dhëna për institucionet e tjera që i procesojnë të dhënat

Një prej punëve që i kryen MAPAS sipas vendimit të rregullativës është mirëmbajtja e regjistrit të anëtarëve dhe regjistrit të anëtarëve të pensionuar të fondeve të detyrueshme pensionale.

Në këtë aspekt, gjatë viteve të kaluara të funksionimit të sistemit, janë konstatuar mungesa/parregullsi të caktuara të të dhënave nga anëtarët e shtyllës së dytë në aspekt të azhurnimit të tyre nga ana e vetë të siguruarve ose për shkak të mungesës së evidencave të të dhënave nga institucionet e involvuara prej ku merren një pjesë e të dhënave. Të siguruarit dhe në përgjithësi popullsia, kanë një sjellje inerte në raport me reagimin e tyre në kohë për të azhurnuar të dhënat e tyre personale, që me gjasë janë rezultat i nivelit ende të ulët relativ të “arsimimit dhe kulturës pensionale” të popullsisë së përgjithshme dhe gjithsesi të motivimit të dobët për azhurnim me vetiniciativë për të dhënat personale që ndryshohen. Gjithashtu një pjesë e institucioneve të inkuadruar në shpërndarjen e të dhënave, për shkak të disa arsyeve, jo rrallë kanë edhe evidencat të mangëta. Ky ndikim negativ i qasjes deri te anëtarësia e rëndon komunikimin me MAPAS dhe shoqëritë pensionale me anëtarët e shtyllës së dytë, që në fund i implikon edhe përmes nivelit të pakënaqshëm të informimit të anëtarëve.

Sistemi vazhdimisht “piqet” përmes rritjes së përfshirjes së popullsisë edhe përmes rritjes së vazhdueshme të mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale me çka rëndësia e sigurimit pensional me financim kapital edhe rritet. Me këtë potencohet rëndësia e mirëmbajtjes së të dhënave të azhurnuara dhe të kompletuara, si nga aspekti i rolit personal të individit, ashtu edhe për shkak të vetëdijes së përgjithshme të publikut dhe përkrahjes së sistemit.

Në drejtim të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të qasjes së anëtarësisë, MAPAS do të zbatojë dhe iniciojë aktivitete për përmirësimin e proceseve për azhurnimin e të dhënave dhe do të kërkojë përmirësimin e evidencave nga të gjitha institucionet që kanë të dhëna burimore për të siguruarit. Azhurnimi do të realizohet përmes aktiviteteve të forcuara të shoqërive pensionale në institucionet shtetërore dhe kompanitë private, përmes përkrahjes së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Anëtarët në shtyllën e dytë që kanë përditësuar të dhëna	1.996	Rritje	Të dhënat e MAPAS
Iniciativat me APRM, Fondi i FPIM dhe DAP	1	3	Të dhënat e MAPAS

Aktivitetet kryesore

1. Aktivitete për azhurnimin e të dhënave dhe anëtareve
2. Komunikimi me APRM, Fondin e SPIM dhe DAP për kontrollimin dhe përditësimin e evidencave

Qëllimi 2.4

MAPAS do të garantojë besueshmëri dhe konsistencë të bazës së të dhënave

MAPAS ka një rol tejet të rëndësishëm në mirëmbajtjen e bazave me të dhëna ku bëjnë pjesë edhe të gjitha të dhënat për anëtarët e fondeve pensionale. Kjo kontribuon për besueshmërinë e të dhënave dhe i jep siguri secilit anëtar se mund t'i ndjek kontributet që u paguhen. Ato të dhëna, duhet t'i mundësojnë MAPAS që t'i kontrollojë të dhënat që shfrytëzohen nga shoqëritë pensionale gjatë realizimit të funksioneve të tyre, siç është komunikimi me anëtarët, ndërsa të dhënat e tyre mund të shfrytëzohen edhe për kontrollin e të dhënave që ruhen nga MAPAS.

Deri më tani nuk janë vërejtur probleme më të mëdha me evidencën e të dhënave për anëtarësinë, të shkaktuara nga incidentet e softuerit (në aspekt teknik ose për shkak të faktorit njeri), por duke marrë parasysh faktin se anëtarësia dhe mjetet edhe më tutje do të vazhdojnë të rriten, MAPAS do të ballafaqohet me një sfidë serioze për të garantuar se të dhënat e sistemit janë të besueshme dhe konsistente. Për këtë arsye, ky obligim edhe në të ardhmen do të jetë prioritet i lartë për MAPAS.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
% e anëtarëve të dhënat e të cilëve janë ndryshuar për shkak të incidenteve në softuerin	0% (shtylla e dytë) 0% (shtylla e tretë)	0% (shtylla e dytë dhe e tretë)	Të dhënat e MAPAS

Aktivitetet kryesore

1. Mirëmbajtja e regjistrit të të dhënave për shtyllën e II-të dhe III-të
2. Kontrollimi i të dhënave për anëtarësinë në shtyllën e III-të

Qëllimi 2.5

MAPAS në mënyrë aktive do të kyçet në realizimin e fazës së pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale.

Gjatë krijimit të sistemit të sigurimit pensional me financim të detyrueshëm kapital, prioritet ishte zhvillimi i mekanizmave për kursim për ditët pensionale.

Duke marrë parasysh se sistemi ishte në përgjithësi, i dizajnuar për gjeneratat më të reja, pagesat e kompensimeve nga sigurimi pensional me financim kapital u vendosen në plan të dytë. Por tani është në fazë të implementimit të rregullativës për pagesën e pensioneve nga shtylla e dytë dhe e tretë që përputhet me periudhën që është përfshirë me këtë Plan Strategjik. Qëllimi është që anëtarët gjatë pensionimit të mund të zgjedhjen ndërmjet anuiteteve që do të sigurojnë kompanitë e sigurimeve dhe tërheqjet e programuara që i ofrojnë shoqëritë pensionale.

Në bashkëpunim me shoqëritë pensionale dhe Agjencinë për Mbikëqyrje të Sigurimit, MAPAS duhet të sigurojë një implementimin e sigurt të pagesës e pensioneve me atë që do të sigurojë se janë krijuar me të gjitha procedurat e nevojshme. Ajo nënkupton se për anëtarët do të duhet të krijohen edhe sistemet dhe burimet e informatave për të cilat do të mund të bëjnë zgjedhjen e vërtetë që përshtaten me rrethanat e tyre. Ajo nënkupton se kjo fazë e pagesës së pensioneve do të harmonizohet me zhvillimin e tregut të anuiteteve pensionale, koncepti i opsioneve të sigurisë për tërheqjet e programuara dhe proceset e krijuara për kontrollin e pagesave të mjeteve nga llogaritë e anëtarëve. MAPAS në këtë fazë do të kontrollojë nëse është bërë organizimi adekuat në kohën e duhur për implementimin e suksesshëm në pajtim me rregullativën ligjore dhe nënligjore.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Realizimi i fazës së pagesës	50%	100%	Të dhënat e MAPAS
Realizimi i proceseve afariste	Pjesërisht	Plotësisht	Të dhënat e MAPAS

Aktivitetet kryesore

1. Fillimi i fazës së pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për zbatimin e drejt të fazës së pagesës, duke i sjellë rreziqet në nivelin më të ulët të mundshëm.
2. Realizimi i proceseve zyrtare përmes fazës së pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale

Qëllimi kryesor 3:

MAPAS do ta përmirësojë kapacitetin në drejtim të forcimit të rolit të vet mbikëqyrës dhe rregullues të sistemit pensional

Kapaciteti i MAPAS është tejet i rëndësishëm për rregullimin e mirë dhe mbikëqyrjen efikase të sistemit pensional. Për ta zhvilluar kapacitetin e vet, MAPAS në periudhën e përfshirë me Planin Strategjik do të orientohet edhe ndaj disa sferave kryesore. Menaxhimi me resurset njerëzore do të jetë një prej çështjeve kyçe për zgjidhjen e të cilave do të ndihmojë edhe në krijimin e një organizimi më profesional. Planet për trajnim do të dizajnohen dhe përgatiten për ta përmirësuar kapacitetin e të punësuarve por edhe të ekipit udhëheqës. Gjithashtu, MAPAS do të menaxhojë me të dhënat në mënyrë më profesionale në pajtim me nevojat e sistemit dhe do t'i ruaj zgjidhjet për mirëmbajtjen e vazhdimësisë zyrtare dhe menaxhimit në rast të katastrofës (katastrofa natyrore dhe jo vetëm). Pastaj MAPAS vazhdimisht do të avancojë të gjitha proceset, procedurat dhe sistemet me qëllim të përmirësimit të efektivitetit të vet zyrtar. MAPAS vazhdimisht do ta ruaj bashkëpunimin me pjesëmarrësit e sistemit në Maqedoni, por edhe jashtë vendit, në drejtim të avancimit të mësimin të përbashkët dhe zhvillimit të sistemit pensional. Në fund, MAPAS do ta ruaj stabilitetin financiar duke siguruar një menaxhim efikas me financat.

Qëllimi 3.1

MAPAS vazhdimisht do ta përsosë profesionalizmin dhe aftësitë e organeve udhëheqëse dhe të punësuarve.

Profesionalizmi dhe aftësia e organit udhëheqës dhe të punësuarve janë faktor kyç për përmirësimin e kapacitetin e MAPAS për sigurimin e një funksionalizimi më të mirë dhe shërbime publike. Mënyra më e mirë për ndërtimin e profesionalizmit dhe aftësisë është përmes menaxhimit me resurset njerëzore. Përmes një menaxhimi përkatës dhe mirë të definuar me resurset njerëzore mund të vendosen në strategji dhe të zhvillojnë politika, standarde, sisteme dhe procese përmes të cilave do të zbatohen ato strategji në të gjitha sferat.

Në MAPAS, në kuadër të Sektorit për çështje juridike ka Seksion për çështje të përgjithshme juridike dhe pjesa më e madhe e aktiviteteve të udhëheqësit dhe këshilltarit për resurse njerëzore në lidhje me menaxhimin e resurseve njerëzore. MAPAS miraton Plan vjetor për punësim sipas të cilit do të konstatohet gjendja ekzistuese dhe planifikohen punësimet e reja.

MAPAS miraton Planin vjetor për trajnimin e të punësuarve në MAPAS sipas Programit për trajnimin e nëpunësve administrativ në Republikën e Maqedonisë që jep mundësi për zhvillimin e aftësive profesionale, teknike dhe sociale të të punësuarve përmes trajnimeve gjenerike dhe të specializuara. Kjo, njëherë do të ndihmojë për shfrytëzimin më të mirë të resurseve njerëzore dhe për motivimin e të punësuarve.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Realizimi i fazës së pagesës	50%	100%	Të dhënat e MAPAS
Realizimi i proceseve afariste	Pjesërisht	Plotësisht	Të dhënat e MAPAS

*Vlerat janë fituar nga anketa e realizuar për kënaqësi të të punësuarve në vitin 2016

Aktivitetet kryesore

1. Përgatitja e Planit vjetor të punësimit
2. Përgatitja dhe zbatimi i Planit Vjetor për trajnimin e të punësuarve në MAPAS
3. Zbatimi i anketës për matjen e shkallës së kënaqësisë së të punësuarve në MAPAS, një herë në vit
4. Përgatitja e analizës për largimin e kuadrove nga MAPAS, një herë në vit.

Qëllimi 3.2

MAPAS vazhdimisht do të sigurojë procese më efikase zyrtare për rregullim, mbikëqyrje dhe kontroll

Proceset zyrtare e promovojnë efektivitetin dhe efikasitetin zyrtar, duke synuar inovacionet, fleksibilitetin dhe integrimin me teknologjinë. MAPAS do të vlerësojë të gjitha proceset, hapat dhe sistemet që janë në funksion dhe do të vazhdojë të përmirësojë proceset zyrtare për rregullim, mbikëqyrje dhe kontroll me qëllim të avancimit të mjedisit të punës. MAPAS do t'i ridefinojë të gjitha proceset, hapat dhe sistemet përmes përsosjes dhe thjeshtësimit të mënyrës së ofrimit të shërbimeve me qëllim të rritjes së efikasitetit zyrtar.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Realizimi i fazës së pagesës	50%	100%	Të dhënat e MAPAS
Realizimi i proceseve afariste	Pjesërisht	Plotësisht	Të dhënat e MAPAS

Aktivitetet kryesore

1. Vlerësimi i të gjitha proceseve, hapave dhe sistemeve operative
2. Avancimki i ambientit të punës

Qëllimi 3.3

MAPAS do të menaxhojë me të dhënat për mënyrën profesionale, moderne dhe efikase dhe të sigurojë mbrojtjen e tyre, do të përsos dhe thjeshtësojë proceset për menaxhimin me të dhënat.

Me qëllim që MAPAS të përgatitet për nevojat teknologjike në rritje, që do të paraqiten viteve në vijim, është e domosdoshme që të vazhdojë me përpilimin e IT strategjisë. Ai dokument përfshinë planifikimin e arkitekturës, planifikimin e shpenzimeve dhe menaxhimit me sigurinë e të dhënave, ndërsa e gjithë kjo do të harmonizohet sipas qëllimeve dhe kontrolleve zyrtare.

Në mënyrë që të ballafaqohet me të gjitha kërcënimet dhe rreziqet, MAPAS e implementoi dhe mirëmbante Sistemin për menaxhimin me sigurinë e informatave (ISO 27001:2013) që siguron nivel adekuat të sigurisë në aspekt të besueshmërisë, disponimit dhe integritetit të mjeteve informative të MAPAS. Plani për vazhdimësinë e punës zyrtare, regjistrin të rreziqeve si dhe planin për trajtimin e rreziqeve që janë pjesë e Sistemit për menaxhimin me sigurinë e informatave, janë kyçe dhe për faktin që sigurojnë ruajtjen e funksionalitetit të institucionit gjatë rasteve të pakëndshme siç është ndërprerja e energjisë, ngecja e IT sistemit, katastrofat natyrore, probleme me furnizimin, etj. Përmirësimi i vazhdueshëm i këtij sistemi për menaxhim me sigurinë e informatave është në drejtim të ruajtjes së vlerës së palëve të interesuara përmes një vlerësimi të vazhdueshëm dhe përmirësimit të sigurisë informative dhe tërë ciklit të pjekurisë së MAPAS.

Në të ardhmen, MAPAS do ta avancojë edhe IT perspektivën – edhe në kontrollin në terren dhe jashtë terrenit, që e realizon me qëllim të forcimit të suksesit të mbikëqyrjes në të ardhmen.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
% e disponueshmërisë së sistemit	99	99	Statistika e sistemit TI
Plani për rimëkëmbje në rast katastrofe dhe plani për mbajtjen e vazhdës afariste	Mirëmbahet dhe përditësohet rregullisht	Mirëmbahet dhe përditësohet rregullisht	Të dhënat e MAPAS
Sistemi për menaxhim me sigurinë e informatave (ISO 27001:2013)	Mirëmbahet dhe përditësohet rregullisht	Mirëmbahet dhe përditësohet rregullisht	Të dhënat e MAPAS

Aktivitetet kryesore

1. Mirëmbajtja e Sistemit për menaxhim me kualitet (ISO 27001:2013) dhe ricertifikimin e saj
2. Azhurnimi i planit për rimëkëmbje në rast të katastrofave dhe planit për vazhdimësinë e punës zyrtare
3. Krijimi i rregullt i specifikave për funksionalitetet dhe përpunimet e reja të sistemit (softuerit) me qëllim të përmirësimit të tij

Qëllimi 3.4

MAPAS vazhdimisht do të bashkëpunojë edhe me trupa të tjerë mbikëqyrës nga vendi dhe jashtë, do të jetë pjesë e shoqatave ndërkombëtare dhe do t'i implementojë proceset dhe rekomandimet më të reja nga sfera e mbikëqyrjes.

Me qëllim të sigurimit të mbikëqyrjes efikase dhe rregullativës së sigurimit pensional me financim kapital, MAPAS do të bashkëpunojë edhe me trupat rregullatorë nga vendi dhe jashtë, si dhe me organe dhe institucione relevante të vendit. Me këto trupa dhe institucione, MAPAS ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi. Përmes këtyre bashkëpunimeve, MAPAS përfiton nga përvojat dhe informatat e mbledhura dhe hulumtimet e ndara nga ana e institucioneve të tjera rregullatore.

Gjatë viteve të ekzistimit, MAPAS ka realizuar bashkëpunim edhe me institucione të ngjashme në disa vende siç janë Bulgaria, Sllovenia, Kroacia, Polonia, Turqia, Rumania, Kosova dhe Shqipëria. Bashkëpunimi përfshinë shkëmbimin e përvojave të fituara në fushën e sigurimit pensional me financim kapital, të punës së fondeve pensionale, mekanizmave për mbikëqyrjen e fondeve pensionale dhe rregullativës së miratuar me masat juridike. Bashkëpunimi i këtillë i ndihmoi MAPAS për të zhvilluar kapacitetin e vet. Gjithashtu nga marsi i vitit 2007, MAPAS është anëtare e plotfuqishme e IOPS – Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve Pensionalë. Anëtarësimi dhe bashkëpunimi me IOPS i ndihmoi MAPAS për të ndjekur trendët në sferën e mbikëqyrjes së shoqërive dhe fondeve pensionale. MAPAS do të vazhdojë që të thellojë këto bashkëpunime.

Nga dhjetori 2013 MAPAS është pjesë e Trupit koordinues të institucioneve rregullatorë të Maqedonisë për edukim financiar, që u formua me qëllim të nxitjes, planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve që kanë për qëllim ngritjen e nivelit të arsimimit financiar të popullsisë në Republikën e Maqedonisë. Trupi koordinues bashkëpunon me disa institucione të sektorit financiar nga vendi dhe jashtë, veçanërisht duke theksuar bashkëpunimin me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik – Rrjeti ndërkombëtar për edukim financiar (OECD-INFE) dhe Organizata Ndërkombëtare për Edukim Financiar të të Rinjve dhe Fëmijëve (CJFI) si organizata dhe institucione ndërkombëtare me renome, që në mandatet e tyre i përpunojnë rregullativat, temat dhe programet për edukim financiar, arsimim financiar dhe inkluzion financiar. MAPAS do ta avancojë praktikën e krijuar të bashkëpunimit dhe do të krijojë strategji për shkak të mirëmbajtjes së lidhjes së suksesshme me trupat e tjerë mbikëqyrës dhe organet dhe institucionet relevante me qëllim që ajo të ndikojë pozitivisht në politikën dhe praktikën e saj.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Masa e takimeve me mbikëqyrës dhe institucione qeveritare në Maqedoni në nivel vjetor	4	Sipas nevojës	Të dhënat e MAPAS
Pjesëmarrja në mbledhje të IOPS dhe takime me mbikëqyrës tjerë jashtë vendit në nivel vjetor	4	3	Të dhënat e MAPAS
Numri i të dhënave të dërguara dhe kërkesa për dorëzim të informatave (rregullisht dhe sipas nevojës)	12	10	Të dhënat e MAPAS
Numri i të dhënave dhe kërkesave të pranura për dorëzim të informatave (rregullisht dhe sipas nevojës)	15	10	Të dhënat e MAPAS

Aktivitetet kryesore

1. Shkëmbimi i informatave dhe pjesëmarrje në takimet me mbikëqyrësit dhe organet relevante
2. Pjesëmarrje në takimet me IOPS dhe mbikëqyrës të tjerë jashtë vendit
3. Komunikimi me IOPS dhe trupat e tjerë ndërkombëtarë të mbikëqyrjes në lidhje me përvojat, ndryshimet dhe inovacionet e tyre.
4. Hulumtimi i ndryshimeve të sistemeve pensionale në botë dhe ndarjen e rezultateve me pjesëmarrësit e brendshëm dhe të jashtëm.

Qëllimi 3.5

MAPAS do të përpiqet për forcimin dhe ruajtjen e stabilitetit të vet financiar me qëllim të zbutjes së ndikimeve në të gjitha segmentet e fushëveprimit duke siguruar një menaxhim efikas të financave

MAPAS vazhdimisht i ndjek gjendjet dhe trendët që kanë lidhje me punën e MAPAS dhe sistemi e avancohet dhe nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital. Në këtë drejtim, planifikohet realizimi i aktiviteteve për rregullimin dhe implementimin e multifondeve dhe pritet krijimi i Qendrës për sistem elektronik të kotacionit. Këto ndryshime do të implikojnë rritjen e kapaciteteve të MAPAS nga kapaciteti rregullator në atë mbikëqyrës, e me këtë edhe shpenzimet për forcimin e kapacitetit kadrovik dhe material të Agjencisë. Gjithashtu, MAPAS vazhdimisht i avancohet dhe përsos proceset zyrtare sipas nevojave dhe kërkesave të paraqitura për të gjitha subjektet e kyçura në sistemin e sigurimit pensional me financim kapital. Proceset zyrtare janë të përkrahura me zgjidhje bashkëkohore softuerike dhe harduerike që kontribuojnë në shpejtësinë e reagimit të MAPAS dhe ndjekjes pa pengesa të secilit ndryshim që shkaktohet në këtë sistem. Për këtë arsye, një pjesë të shpenzimeve të MAPAS janë për infrastrukturën e saj informatike.

Sigurimi pensional me financim kapital paraqet segmentin e dytë më të madh në sistemin financiar të Republikës së Maqedonisë dhe është një prej segmenteve me rritje më të shpejtë të sistemit financiar. Në vitin 2016 mjetet e fondeve private pensionale ishin 9,4% nga sektori i përgjithshëm financiar. Me këtë rast pritet një trend i përfshirjes së popullsisë dhe të vazhdojë edhe më tutje rritja e mjeteve për fondet private pensionale. Kjo ndikon drejtpërdrejtë edhe në rritjen e përgjegjësisë së MAPAS si një trup mbikëqyrës dhe rregullues në këtë segment, para të siguruarve dhe publikut.

Me analizat e mënyrës së tanishme të përlllogaritjes dhe arkëtimit të kompensimit me të cilin financohet puna e MAPAS, është konstatuar se shkalla e punësimeve dhe masave populiste kanë ndikim negativ në kompensimin e strukturuar momental, respektivisht nivelit të frekuencës së kontributeve që ndikojnë drejtpërdrejtë në financimin e MAPAS. Për tejkalimin e këtyre ndikimeve, stabilizimit të të hyrave si dhe harmonizimin me praktikën e huaj, me qëllim të realizimit të aktiviteteve që dalin nga zhvillimi i mëtejshëm i sistemit, në bazë të analizave të përpiluara dhe duke siguruar kufizime maksimale për të përcaktuar nevojën për ndryshimin e mënyrës së përlllogaritjes së kompensimit që e arkëton MAPAS nga shoqëritë pensionale.

Për këtë, MAPAS do të iniciojë ndryshim ligjor për mënyrën e përlllogaritjes së kompensimit, respektivisht arkëtimit të kompensimit mujor në llogarit të shoqërive pensionale, të përlllogaritur si përqindje e mjeteve të përgjithshme për çdo fond pensional me të cilin shoqëria pensionale. MAPAS do të sigurojë një mirëmbajtje të vazhdueshme të stabilitetit financiar dhe menaxhimit efikas me financat, përfshirë edhe kontrollin e shpenzimeve operative dhe shfrytëzimit minimal të të hyrave.

Në këtë drejtim, MAPAS do të bëjë analiza të raporteve financiare, do t'i rishqyrtojë vendimet për kompensimet dhe do ta përcaktojë nevojën për përpilimin e analizave plotësuese në lidhje me financimin e MAPAS.

Masa	Viti i bazës (2016)	2020	Burimi i të dhënave
Analiza të raporteve financiare të MAPAS	2	2	Të dhënat e MAPAS
Vendime për kompensime të cilat i arkëton MAPAS	2	2	Të dhënat e MAPAS
Iniciativat për ndryshim të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital në MPPS	1	ndryshime të ligjit	Të dhënat e MAPAS

Aktivitetet kryesore

1. Analiza e raporteve financiare të MAPAS
2. Rishqyrtimi i kompensimeve që i arkëton MAPAS
3. Hulumtimet për mënyrën e financimit të mbikëqyrësve dhe rregullatorëve në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit në shtetet me sisteme të ngjashme pensionale
4. Propozimet për ndryshimin e dispozitave të ligjit me të cilat rregullohet financimi i MAPAS

Plani financiar për realizimin e planit strategjik

Gjatë periudhës trevjeçare në të cilën duhet të realizohet Plani Strategjik, janë planifikuar shpenzime në shumë të përgjithshme prej 50,3 milion denarë për vitin 2018. Për vitin 2019 dhe 2020 projektimi është se shpenzimet do të jenë 51 milion denarë dhe 52 milion denarë në mënyrë adekuate. Mesatarisht 12,09% të shpenzimet e përgjithshme që janë paraparë si shpenzime të përgjithshme të punës, ndërsa të 87,91% e mbulojnë realizimin e tre qëllimeve.

Tabela: Plani financiar për realizim të planit strategjik

	<i>Mijëra denarë</i>			<i>Shpërndarje</i>		
	2018 2019 2020			2018	2019	2020
	(Mesat.)	(Mesat.)	(Mesat.)			
Qëllimi 1: MAPAS do të sigurojë menaxhim me rreziqe që u kërcënohen mjeteve dhe pensioneve dhe kompensimeve pensionale të anëtarëve, si dhe reputacionit të sistemit, dhe ato t'i reduktojë në nivel më të ulët të mundshëm.	11.600	11.948	12.545	23,05	11.600	11.948
Qëllimi 2: MAPAS do të kontribuojë në zhvillimin e sistemit të sigurt dhe transparent pensional i cili do të ketë mbështetjen e anëtarëve dhe publikut	3.768	4.144	4559	7,48	8,12	8,76
Qëllimi 3: MAPAS do ta përmirësojë kapacitetin në drejtim të përforcimit të rolit mbikëqyrës në sistemin pensional	28.200	28.764	29.339	56,03	56,38	56,39
Shpenzimi total për aktivitetit	43.568	44.875	46.444	86,56	87,91	89,26
Shpenzimi i përgjithshëm administrativ	6.756	6.142	5.583	13,44	12,09	10,74
Shpenzimet buxhetore totale	50.324	51.017	52.027	100,00	100,00	100,00

Pjesa më e madhe ose rreth 56,3% të mjeteve të përgjithshme të planifikuara që janë të dedikuara për realizimin e Qëllimit 3. Arsyeja kryesore për të cilën qëllimi i tretë përfshinë një pjesë të madhe të buxhetit të MAPAS është se ky qëllim është i lidhur me zhvillimin e kapacitetit institucional të MAPAS, që planifikohet vazhdimi me periudhën trevjeçare në fjalë. Sipas shpërndarjes e shpenzimet, për realizimin e pjesës së parë janë planifikuar 23,5% ndërsa për qëllimin e dytë 8,1% të mjeteve të planifikuara në përgjithësi.

Grafik: Shpërndarja e mjeteve buxhetore në pajtim me qëllime



Konkluzion

MAPAS si institucion rregullator i përkushtuar në mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale, si dhe nxitjen e zhvillimit të shtyllës së dytë dhe të tretë pensionale, fuqishëm beson dhe pret se përmes realizimit të aktiviteteve të përditshme, do ta realizojë Planin strategjik 2018-2020.

Realizimi i Planit strategjik 2018-2020 do të ketë ndikim të madh në forcimin e komponentit të financiar kapital të sistemit pensional të vendit tonë, përmes forcimit të menaxhimit me rreziqe dhe kontribut për zhvillimin e një sistemi të sigurt dhe transparent pensional, që ka përkrahje të anëtarësisë dhe publikut, si dhe përmes përmirësimit të kapacitetit të MAPAS në drejtim të forcimit të rolit të tij mbikëqyrës dhe rregullues të sistemit pensional.

Shndërrimi i këtij plani një praktikë reale do të paraqesë një indikator për matjen e performancave të sigurimit pensional me financim kapital në drejtim të realizimit të misionit të tij për të pasur ditë më të sigurta pensionale për qytetarët e Republikës së Maqedonisë.